



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:269731
Datë: 19.01.2024
Numri i dokumentit: 05212135

C-IV-13-2593

Ankuesi

R J, Gjilan

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, NSH “IBG” (ne likuidim), Rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 19 janar 2024 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI058-0528 i datës 11 tetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 24 tetor 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme ankesë kundër vendimit nr. GJI058-0528 të datës 11.10.2013 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (me tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2003 – dhjetor 2006 në shumë prej 814.00 Euro nga N.SH. ”IBG ” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se është i pakënaqur me vendimin e AL dhe në afatin e paraparë ligjor e parashtron ankesën për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, vlerësimit jo objektiv për nxjerrjen e vendimit dhe shkelës së të drejtave të njeriut. Ankuesi propozoi që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar . Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar vendimin e kundërshtuar dhe njoftimin e datës 24 mars 2006.

Ankuesi ka pohuar se arsyetimi i vendimit të AL-së është i pa qëndrueshëm sepse në rastin konkret nuk mund të zbatohet dispozita e ligjit të mëparshme të Marrdhenies së punës me qenë se rregullisht ka bërë kërkesa në drejtim të realizimit të së drejtës së tij sipas kësaj baze andaj afati i ri rrjedh pas çdo kërkesë të fundit. Ankuesi propozoi që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar . Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar vendimin e kundërshtuar .

Me 12 shkurt 2014, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin, duke kërkuar nga ankuesi që të dorëzojë prova shtesë në mbështetje të ankesës. Ankuesi nuk ishte përgjigjur urdhrin të gjykatës .

Me 27 korrik 2023, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin, duke kërkuar nga ankuesi që të dorëzojë prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij .

Ankuesi urdhrin e ka pranuar me 24 nëntor 2023 por nuk ka parashtruar asnjë prove në mbështetje të ankesës së tij .

Me 28 dhjetor 2023, AKP-ja në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Më tej, e paditura pohoi se ankesa e parashtruar nga parashtruesi nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç parashihen nga neni 74.2 i Ligjit 06/L-086.

E paditura gjithashtu konsideron se është e rëndësishme që të theksohet se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e Vendimit të AL-së, kështu që neni 74.2 i Ligjit 06/086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen është shkelur nga ana e AL në marrjen e vendimit, kështu duke bërë shkelje të nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086, dhe në pajtim me qëndrimin e vetë parashtruesit, vendimi sipas të paditurës, nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034, prandaj edhe nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar vendimin.. E paditura konstaton se nuk ka asnjë provë para AL, që parashtruesi e ka paraqitur këtë kërkesë para ndonjë Gjykate apo organit tjetër kompetent. Gjykatës i propozon që ankesën e ankueses të refuzoj si të pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur

parashtrës apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i e NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën për të cilën është ushtruar kërkesa, dëshmi se ka ofruar shërbime pune për periudhën e lartcekur, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova në mbështetje të ankesës së tij edhe pas pranimit të urdhërave të lëshuar nga gjykata. Gjkata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000.00 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrëhet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha, Gjyqtare